

**VENDIM**  
**Nr. 38/2024**

**PËR EMËRIMIN E ZONJËS MIMOZA KAÇI, ANËTARE E BORDIT  
TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE, NË FUNKSIONIN  
E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozim të Këshillit të Ministrave me VKM-në nr. 641, datë 22.11.2023, “Për propozimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidaturës së një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për ushtrimin e funksionit të drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Autoritetit”,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Zonja Mimoza Kaçi, anëtare e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, e cila mban funksionin e nëndrejtorit ekzekutiv, lirohet nga ky funksion dhe emërohet në funksionin e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv të Autoritetit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miratuar në datën 11.4.2024.